



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË
LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: “GODINË BANIMI DHE SHËRBBIMI ME
1,7,8 DHE 16 KATE MBITOKË ME 2 KATE PARKIM NËNTOKË”, ZONA 06,
ZONA E MENAXHIMIT A05, ME VENDODHJE NË “MARINA DHE JAHTET E
DURRËSIT”, BASHKIA DURRËS, ME SUBJEKT
ZHVILLUES SHOQËRINË “DURRËS MARINA” SH.A.

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.U.

Z. EDI RAMA

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Znj. Belinda Balluku

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit Nr. 13, Datë 28.05.2025

Projektues

“MVM Architecture, Construction & Development” sh.p.k.”

Zhvillues

Shoqeria : “DURRËS MARINA” SH.A.

Elistab Hysni

DURRËS MARINA
SH.A.
NUIB/M31423504A
Durrës - Albania

TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
 - 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
 - 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
 - 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
 - 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
 - 5.2 Aksesit në objekt



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized cursive letters, located at the bottom right of the page.

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Ndërtimit për objektin: "GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI ME 1,7,8 DHE 16 KATE MBITOKË ME 2 KATE PARKIM NËNTOKË", ZONA 06, ZONA E MENAXHIMIT A05, ME VENDODHJE NË "MARINA DHE JAHTET E DURRËSIT", BASHKIA DURRËS, Me subjekt zhvillues shoqërinë "DURRËS MARINA" SH.A bazuar ne:

- Plani i Përgjithshëm Vendor i Durrësit Data 27.07.2022;
- VKM 408, datë 13.05.2015; me përditësime; "Per Miratimin e Rregullores për Zhvillimin e Territorit
- Ligji Nr.107/2014, datë 31.07.2014; me përditësime; "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit
- VKM Nr. 494, datë 21.07.2022; Për disa ndryshime në vendimin nr. 861, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina dhe jahtet e Durrësit (Dures Yachts & Marina)", dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Portual Durrës tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë"
- Ligji Nr. 79/2022, datë 21.12.2022; "Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, Sh.a. dhe NshmiDevelopment L.L.C per projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit "
- VKM Nr. 685, datë 26.10.2022; Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 861, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin ne fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik 'Marina dhe jahtet e Durrësit (Dures Yachts & Marina)', të ndryshuar ";
- VKM Nr. 115, datë 01.03.2023; "Për transferimin në pronësi te shoqërise "Albanian Seaports Development Company" sh.a., të pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës ";



1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

Sheshi i ndërtimit ndodhet në Zonën 06, zona e menaxhimit A05, zona kadastrale: Z.K. 8514; Nr. pasurie 18/16 dhe në këtë pronë nuk ndodhen ndërtesa ekzistuese, të regjistruara dhe informale.

Sheshi ka një sip. 5942.46 m², pjesë e një sipërfaqe prej 230 852.21 m², në zonën e portit të Durrësit, një zonë e rëndësisë kombëtare, e cila zotëron potencialin e duhur për të shfrytëzuar maksimalisht asetet e saj. Projekti synon të zhvillojë këtë nyje kyçe të qytetit me anë të rikonceptimit të portit dhe zonës përreth, me një propozim për waterfrontin e ri të qytetit, duke integruar zonën rezidenciale dhe atë të plazhit, si dhe marinën për të orientuar turizmin vendas drejt atij elitari.

Zhvillimi aktual i Portit të Durrësit, ka kontribuar në formimin e infrastruktures inxhinierike duke e kthyer zonën në një hapësirë të përshtatshme për investime të mëtejshme. Stacioni hekurudhor ekzistues i Durrësit ndodhet afër pjesës veriore të Fazës 1 dhe me rehabilitimin e të gjithë rrjetit hekurudhor pritet që flukse të mëdha udhëtarësh dhe turistesh të frekuentojnë zonën.

Gjatë studimeve fillestare të vendit paraqitet toka e sipërme e zhvillimit e ndotur rëndë për shkak të operacioneve aktuale të magazinimit të portit dhe qymyrit.



Fig. 1. Vendndodhja (pozicioni gjeografik)



Zona per zhvillim
Fig. 2. Pozicionimi ne planin e detajuar Durres




Fig.3. Pozicionimi në planin e detajuar Durrës
i zonës 06, zona e menaxhimit A05



[Handwritten signature]

2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së

Duke u bazuar në regulloren e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Durrës, të miratuar pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, me Vendimin nr. 4, datë 27.07.2022, "Për miratimin e Planit të Detajuar Vendor të njësisë strukturore DR_UB_S1_480/211", për zonën e interesit; parcela që do të zhvillohet është e vendosur në zonën strukturore DR_UB_S1_480/211, në sistemin territorial UB.

Projekti i Masterplanit ka vlerësuar dhe respektuar të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës, rregullat dhe kriteret që propozon "Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës".




Zona për zhvillim
Fig. 4. Hartë e njësisë strukturore Durrës

2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV-së për zonën në zhvillim

Me poshtë paraqiten të gjitha hartat nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës, në të cilat mendohet së propozimi i projektit "MARINA & JAHTET E DURRËSIT," ME VENDNDODHJE BASHKIA DURRËS, prezantuar në dosierin e projektit bashkëlidhur, do të jete funksional, dhe në përputhje me kërkesat e zhvillimit të zones në të ardhmen.



Handwritten signature in blue ink.



LEGJENDA

- | | | | |
|--|-----------------|--|-------------------------|
| | Metropol | | Nyje infrastrukturë |
| | Qendër parësore | | Aeroport |
| | Qendër dytësore | | Port |
| | Qendër terciare | | Zonë e urbanizuar |
| | Aks rrugor | | Zonë ekonomike |
| | Hekurudhë | | Hapësirë ujë rekreative |
| | Transport detar | | Zonë e gjelbrës |



[Handwritten signature]

3. Analiza e gjendjes ekzistuese

Prona shtrihet përgjate rrugës së Doganës dhe ka akses të drejtpërdrejtë nga kjo rrugë e cila do të riprojektohet. Rruga është me dy sense kalimi dhe i ka shërbyer për një kohë të gjatë Portit aktual të Durrësit.

Në anën tjetër pronë kufizohet nga vija bregdetare e qytetit të Durrësit e cila aktualisht është pjesë e Portit të Durrësit prandaj dhe nuk shfrytëzohet nga qytetaret. Vija bregdetare dhe zona e plazhit do të jenë gjithashtu pjesë e projektit që do të sjellin zhvillim dhe aktivitete të cilat do të jenë tërheqëse për turistët.

Funksioni ekzistues në zonë është port detar. Më poshtë janë paraqitur foto të gjendjes ekzistuese të pronës



Fig. 5. Foto nga gjendja ekzistuese

Koncepti

Vizioni i Durrës Yachts & Marina është të ketë një zhvillim dinamik me zona me karaktere të ndryshme. Strategjia Urbane siguron një jetë cilësore dhe zhvillim të qëndrueshëm me integrimin në strukturën urbane të qytetit. Koncepti i masterplanit synon të shfrytëzojë në mënyrën më të mirë mundësitë e mëdha që ofron qarku i Durrësit për investime të reja.

Hapësirat publike cilësore janë elementi kryesor i Konceptit të Strategjisë Urbane. Ndërsa njerëzit ndërveprojnë në hapësirën publike, Masterplani siguron pamje të jashtëzakonshme ndaj detit dhe qytetit, shfaqet një model blloqesh dhe ndërtesash që mishëron vërtet ndërtimin e qytetit. Plani përfaqëson manifestimin fizik të Vizionit dhe Parimeve dhe shoqërohet me rregulla për të udhëzuar zhvillimin e komunitetit të ardhshëm. Ofrohet një komunitet i ri i lidhur nga hapësira publike dinamike, emocionuese, e rrethuar nga ndërveprimet me ujën, hapësirën e hapur, një larmishmëri përdorimesh dhe një sere formash dhe lartësish ndërtimi, të gjitha në shkallë njerëzore.



Handwritten signature in blue ink.





Fig. 6. Rilevimi topografik i gjithë zones(A05)

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE			
ZONA KADASTRALE:	8514	KODI UNIK:	8514
NUMRI PASURISË:	18/16	INDEX I HARTËS:	DR-K-8



DREJTORI

Ramona SH. 1: 5000
Data e krijimit: 2017/07/20

SHPJEGUES
PARCELA
NDERTESA



Vërtetuesi elektronik nga Drejtoria
Vendosja: 2017/07/20 10:15:00
MD: 70699112053072818104314914

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vërtetuar me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Durres)

Fig. 7. Harta e pronësisë A05



[Handwritten signature]

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

Masterplani përbëhet nga funksionet e mëposhtme:

Banim

Shërbime

Infrastruktura

Aktivitete

Koncepti volumor

Ne objektin e propozuar "Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-7-8 dhe 16 kate mbitokë me 2 kate parkim nëntoke, kati Përdhe është rezervuar për Shërbim, Parkim dhe Hollet e hyrjeve. Kati i Parë shërben për banim dhe ka një oborr të brendshëm të gjelbëruar dhe hapësira rekreacioni dhe lojra për fëmijë. Katet nga Niveli 2 deri në 7 dhe Kulla nga Niveli 1 deri në 15 janë të dedikuara për banim.



Fig. 8. Aksonometri volumore A05




Fig. 9. Plani i katit nëntoke -2




Fig. 10. Plani i katit nëntoke -1

Kati i nëntokës -2 përfshin vende parkimi, hapësira për depozitim dhe hapësira teknike si rezervuar uji, pompa, etj. Në pjesën jugore është vendosur rampa për lidhjen me Nivelin -1. Në këtë kat kemi 120 vende parkimi. Kati nëntoke -1 përfshin vende parkimi, hapësira për depozitim dhe hapësira teknike. Në pjesën jugore është vendosur rampa për lidhjen me katin -2, si dhe për lidhjen me hotelin. Gjithashtu, në këtë pjesë kemi hollin e hyrjes me shkallë për lidhjen me hotelin. Në këtë kat kemi 110 vende parkimi.



[Handwritten signature]




Fig. 11. Plani i katit përdhe

Kati Përdhe përfshin shërbime, vende parkimi, hyrjet dhe daljet për raste emergjente, njësi depozitimi dhe gjithashtu hapësira teknike. Në këtë kat ka 57 vende parkimi ku 4 prej tyre janë vende parkimi për persona me aftësi të kufizuara. Hyrjet për banoret ndodhen në pjesën jugore, lindore dhe perëndimore të ndërtesës. Hyrja për makinat është në pjesën veriore. 3 dalje për emergjencë ndodhen në pjesën veriore, jugore dhe lindore të ndërtesës që çojnë në një korridor me dalje të menjëhershme jashtë. Në pjesën jugore të ndërtesës brenda është vendosur rampa që lidh këtë kat me katin nëntokës dhe me hotelin. Në pjesën jugperëndimore të ndërtesës ka një shkallë jashtë që bën lidhjen me oborrin.



[Handwritten signature]



Fig. 12. Plani i katit të parë

Kati i Parë shërben për banim. Në total, ka 31 apartamente. Ato ndahen në 14 ap me 1 dhomë gjumi dhe 17 ap me 2 dhoma gjumi. Shkallët dhe blloqet e ashensorëve janë vendosur në cepat e brendshëm të ndërtesave. Pranë shkallëve kemi ambientet teknike të dedikuara për sistemet HVAC për apartamentet, në mënyrë që të mos ketë kondicionerë në ballkone.




Fig. 12. Plani i katit të dytë



[Handwritten signature]

Në pjesën qendrore mes ndërtesave kemi një oborr të brendshëm dhe hapësira rekreacionale me kënd lojëra për fëmijë. Ka në total 31 apartamente. Ato ndahen në 13 ap me 1 dhomë gjumi dhe 18 ap me 2 dhoma gjumi. Shkallët dhe blloqet e ashensorëve janë vendosur në cepat e brendshëm të ndërtesave.




Fig. 13. Plani i katit tip 3.4.5.6

Kati tip, i cili përsëritet në nivelet 3, 4, 5 dhe 6, është rezervuar vetëm për banim. Ka në total 31 apartamente. Ato ndahen në 13 ap me 1 dhomë gjumi dhe 18 ap me 2 dhoma gjumi.




Fig. 14. Plani i katit të 7-të



[Handwritten signature]

Kati i 7-të ka në total 20 njësi apartamente. Ato ndahen në 8 ap me 1 dhomë gjumi, 8 ap me 2 dhoma gjumi dhe 4 ap me 3 dhoma gjumi. Në këtë kat, kulla është ndarë nga ndërtesa pranë dhe mes tyre ka një tarrace.




Fig. 15. Plani i katit tip 8-15

Kati tipik i kullës, i cili përsëritet në nivelet 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, kanë total 3 apartamente të mëdha. Ato ndahen në 2 ap me 2 dhoma gjumi dhe 1 ap me 3 dhoma gjumi. Çdo apartament ka një ballkon të madh.



[Handwritten signature]




Fig. 16. Ndarje skematike e shpërndarjes së tipologjisë së ap.



Fig. 17. Fasada Jugore e objektit



[Handwritten signature]




Fig. 18.Fasada Veriore e objektit




Fig. 19.Fasada Lindore e objektit



[Handwritten signature]



Fig. 20. Fasada Perëndimore e objektit




Fig. 21. Prerje 1-1



[Handwritten signature]





Fig. 22. Prerje 2-2

Dizajn i peisazhit



[Handwritten signature]




Fig. 23. Dizajn i peisazhit

Në hapësirën ndërmjet objekteve kemi një podium që shërben si një zonë rekreative me kënde lojërash dhe gjelbërim bimësi të lartë dhe të ulët. Hyrja realizohet nëpërmjet shkallëve të jashtme të pozicionuara në pjesën jug-perëndimore të sheshit. Apartamentet që ndodhen rrotull kësaj hapësire kanë veranda me akses të drejtpërdrejtë me porta individuale.

4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave

Ndërtimi i masës volumore ka një ndikim vizual shumë të rëndësishëm. Ajo duhet të synojë të krijojë pika interesi dhe nyje, si dhe të lejojë aksesin vizual nga zonat e brendshme drejt bregdetit, ose në pikat kryesore tërheqëse, si Parku dhe Sheshet. Diversiteti në masën e ndërtimit, veçanërisht në lartësi, rekomandohet për të shmangur një imazh urban monoton.

Në këtë mënyrë objekti që propozohet krijon një larmishmëri vizuale me ane të teksturave dhe kontrastit të ngjyrave, për të shmangur monotoninë.

Në projektimin e fasadës janë përdorur materiale resistente dhe estetike, sipas standarteve bashkëkohore.

Paleta e materialeve

Materialet që janë përdorur për ndërtesën A05 janë gurë për katin e parë, sistem kapote me grafiato me ngjyre të bardhë dhe gri ndërsa në 5 katet e fundit të kullës trajtimi i grafiatos bëhet si imitim druri.



[Handwritten signature]

Materialet e fasadës:



Suva RAL 9003



Panel EPS me fuga
vertikale RAL 7043



Suva RAL 7043



Panel EPS dekorativ
imitim druri



Suva RAL 9011
Lyerje kangjella metalike



Gur i Shkodrës

Fig. 24. Skedë e materialëve të propozuara



[Handwritten signature]



Fig. 25. Rendera të Objektit



[Handwritten signature]



Fig. 26. Rendra të Objektit



[Handwritten signature]



Fig. 27. Rendra të Objektit



A handwritten signature in blue ink, appearing to be "D. J. K.", located below the official stamp.



Fig. 28. Rendra të Objektit



[Handwritten signature]

IMAZHE TË INTERIORIT TË HOLLIT




Fig.29 _Imazhe të interiorit të hollit hyrës





Fig.30_Imazhe të interiorit të hollit hyrës




[Handwritten signature]

4.3 Përcaktimi i treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	5942.46 m ²
Sipërfaqe e truallit që përdoret për zhvillim:	5942.46 m ²
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	5221.25 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	33349.73 m ²
Sip. ndërtimi nën tokë	11331.34 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi dhe nën tokë:	44681.07 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	87.9 %
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike:	12.1 %
Intensiteti i ndërtimit:	5.61
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	60.30 m
Numri i kateve mbi tokë:	1-7-8-16 kat
Numri i kateve nën tokë:	2 kat



LEGJENDË:

- kufiri i pronës
- kufiri i natës
- vija e objektit
- vija e ballkoave
- ▲ hyrje-dalje ndërmjet objekteve
- ▲ hyrje-dalje në parkim

- Objekti i propozuar
- Gjellërimi i ujit
- Park për stazhë

Fig. 31. Planvendasje e Përgjithshme



[Handwritten signature]

4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet

Hapësira publike

Ne pjesën qendrore ndërmjet ndërtesave mbi podium 1kt kemi një hapësirë çlodhese dhe një kënd lojërash për fëmijë. Hyrja bëhet përmes një shkalle të jashtme në pjesën jugperëndimore. Linjat e harkuara të truarëve orientojnë lëvizjen e njerëzve drejt qendrës, por gjithashtu bëjnë shpërndarjen e flukseve drejt hyrjeve të apartamenteve. Për të bërë të mundur mbjelljen e pemëve në pjesën qendrore, kati është ulur rreth 1.2m. Zona e banuar është kufizuar me bimësi.

Vendparkimet

Parkimi është llogaritur për të plotësuar nevojat për banorët por edhe për ambientet tregtare që ndodhen në katin përdhe. Realizohet në 2 katet nëntoke dhe pjesërisht në katin përdhe.

Hyrja ne parkim realizohet ne pjesen veriore të sheshit dhe nëpërmjet rampave zbresim ne katet -1 dhe -2.

Në katin nëntoke -2 kemi 120 vende parkimi, në katin -1 kemi 110 vende parkimi dhe ne katin përdhe kemi 57 vende parkimi ku 4 prej tyre janë te rezervuara për persona me aftësi të kufizuara.

Në total kemi 287 vende parkimi.






Fig. 32. Hapësirat publike



[Handwritten signature]




Fig. 33. Hapësirat e gjelberta




Fig. 34. Parkimet



[Handwritten signature]

5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

5.1 Pozicionimi i shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Infrastruktura e Fazës 1 është shtylla kurrizore e vizionit të këtij Master Plani dhe siguron rrjedhën e qetë të trafikut dhe lidhje të fortë me qendrën e qytetit dhe zonën historike. Ky vizion është strukturuar kryesisht me rrugët kryesore dhe dytësore që integrohen me rrjetin e qyteteve dhe siguron lëvizjen e nevojshme për të gjithë Masterplanin. Infrastruktura është e optimizuar për të siguruar komoditetin mjedisor për këmbësorët, çiklistët dhe makinat.

Ky projekt nuk prezanton asnjë ndryshim apo propozim të ri për infrastrukturën rrugore kryesore, por respekton plotësisht gjendjen ekzistuese, dhe propozimin e planit të ri të Bashkisë Durrës, për sa i përket rrjetit të infrastrukturës rrugore që ka zona.




Fig. 35. Infrastruktura e projektit

5.2 Aksesit në objekt

Aksesi në objekt bëhet nga të katër anët e objektit, që korrespondojnë dhe me hyrjet përkatëse në të 4 godinat.

Hyrja për në parkim në katin përdhe bëhet nga ana veriore e objektit, ndërkohë që aksesit në parkimet nëntoke realizohet nepermjet aksesit nga objekti H01.

Hyrjet për banorët dhe shërbimet janë sipas standarteve , ku janë parashikuar dhe rampat e nevojshme për PAK.



Fig. 36. Plani i vendosjes së strukturës

